



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 9.5.2022, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço- kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”.

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Antoneta Dhima, Bardhyl Kollçaku, Toni Gogu, Pranvera Resulaj, Denis Deliu, Ilirjan Pendavinji, Vullnet Sinaj, Flamur Noka, Lindita Metaliaj, Luan Baçi, Isuf Çelaj dhe Kasem Mahmutaj.

Mungojnë:

Xhemal Qefalia, Ferdinand Xhaferraj, Paulin Sterkaj, Luan Duzha, Agron Çela, Enkelejd Alibeaj dhe Ervin Salianji.

Të ftuar:

Adea Pirdeni – Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Hartimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Elena Xhina – Këshilltare e Ministrit të Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar kolegë,

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare me rend dite shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”.

Sigurisht, Komisioni i Sigurisë Kombëtare është komision përgjegjës.

Të ftuar janë zonja Adea Pirdeni, zëvendësministre e Drejtësisë, zoti Besmir Beja, drejtori i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Hartimit të Legjislacionit, zonja Elena Xhina, këshilltare e Ministrit.

Faleminderit!

Relatore është zonja Antoneta Dhima.

Fjala është për ju, zonja Pirdeni.

Adea Pirdeni – Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot ju paraqitet për shqyrtim projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, ose thënë ndryshe Konventa 108.

Kjo Konventë, së bashku me protokollet e saj ndryshuese, përbën bazën e legjislacionit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale për mbi 50 shtete dhe të vetmin instrument ligjor detyrues në nivel ndërkombëtar në këtë fushë. Kjo Konventë dhe një prej protokolleve të saj shtesë, përkatësisht protokollin 181, është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë që në vitin 2004.

Konventa 108 është miratuar në vitin 1981, shumë kohë përpara zhvillimit të mjeteve të reja të komunikimit elektronik. Epoka digjitale e dekadave të fundit ka sjellë jo vetëm diversifikimin, por edhe intensifikimin e qarkullimit të informacionit me të dhëna personale në mjedisin digjital, duke përballur të gjithë sistemin e mbrojtjes së të dhënave personale me sfida të reja.

Qëllimi i protokollit ndryshues nr. 223, të cilin synon të ratifikojë projektligji që ju paraqitet sot për shqyrtim, synon pikërisht përmirësimin e efektivitetit të zbatimit të Konventës

108, me qëllim garantimin e një përgjigjeje adekuate, ligjore dhe institucionale në drejtim të forcimit të mekanizmave të mbikëqyrjes së Konventës. Ky protokoll synon të rrisë ndjeshëm nivelin e mbrojtjes dhe sigurisë për të dhënat personale, si dhe harmonizimin në nivel evropian të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, si një parakusht për qarkullimin dhe shkëmbimin e të dhënave midis shteteve.

Protokolli ndryshues është hartuar në të njëjtën linjë me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, thënë ndryshe GDPR-në e vitit 2016, dhe direktivën e policisë së Bashkimit Evropian, po të vitit 2016, me qëllim që palët kontraktuese të mos kenë konflikt me detyrimet që burojnë nga legjislacioni evropian, duke marrë në konsideratë se shumë shtete janë në proces të harmonizimit të legjislacionit të tyre të brendshëm me këto akte të *acquis* të Bashkimit Evropian, sikurse edhe Republika e Shqipërisë.

Më konkretisht, për dijeni të anëtarëve të nderuar të këtij komisioni, do të doja t'ju bëja me dije se miratimi, gjithashtu, i aktit, praktikisht i projektligjit “Për të dhënat personale”, i cili për afro direktivën e policisë, si dhe rregulloren e përgjithshme të BE-së “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, është parashikuar në planin kombëtar për integrimin evropian, si një akt që do të shqyrtohet dhe do të paraqitet për shqyrtim në Kuvend në 6-mujorin e dytë të këtij viti.

Në terma të përgjithshëm, risitë e këtij projektakti konsistojnë në disa drejtime: synohet shtimi i të drejtave të subjekteve të të dhënëve për të ushtruar kontroll mbi këto të drejta; synohet zgjerimi i detyrimeve të kontrolluesit të të dhënave në raport me subjektin që i përpunon këto të dhëna; është zgjeruar kategoria e të dhënave sensitive, përpunimi i të cilave do të lejohet vetëm kur garancitë e duhura janë të parashikuara shprehimisht në ligj; është parashikuar një regjim i saktë i flukseve të të dhënave në nivel ndërkombëtar; janë sanksionuar kërkesa më të forta në lidhje me masën e proporcionalitetit dhe parimet e minimizimit të të dhënave, si dhe ligjshmërinë e përpunimit të tyre.

Me ratifikimin e protokollit ndryshues Shqipëria i nënshtrohet detyrimit për të lejuar komitetin e konventës të vlerësojë efektivitetin e masave që ka marrë në legjislacionin e saj të brendshëm për të zbatuar dispozitat e kësaj konvente, të modernizuar tashmë. Gjithashtu, ngritja dhe forcimi i bazës ligjore do të lehtësojnë më tej bashkëpunimin ndërkombëtar midis autoriteteve mbikëqyrëse në fushën e të dhënave personale dhe shteteve të huaja palë në këtë konventë.

Projektligji i paraqitur për shqyrtim përmban 4 nene.

Në nenin 2 të këtij projektligji parashikohet caktimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si autoritet mbikëqyrës dhe jo thjesht si institucion apo autoritet bashkëpunues, sikurse ka qenë në ligjin “Për ratifikimin e konventës 108”, në vitin 2004.

Në nenin 3 parashikohen shfuqizime të përcaktimeve ligjore, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me protokollin ndryshues, objekt ratifikimi, përcaktimet e të cilit kërkojnë domosdoshmërisht harmonizimin me aktet e tjera ligjore dhe koherencën e brendshme juridike.

Nga pikëpamja procedurale, konventa është miratuar në parim me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1001, datë 9.12.2020 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i përhershëm në misionin e përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Europës, zoti Dastid Koreshi, në datën 28.1.2022, në respektim të plotë të të gjithë kuadrit ligjor dhe kushtetues “Për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare” dhe integrimin e tyre në sistemin juridik vendas.

Projektakti ka kaluar përgjatë të gjithë procesit të konsultimit të projektakteve me institucionet përkatëse, përfshirë këtu edhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Së fundi, duam t’ju rikujtojmë se përmes këtij projektakti synohet të zgjerohet sfera e mbrojtjes së dhënave personale. Kjo iniciativë ligjore u përgjigjet kërkesave bashkëkohore për vigjilencë të shtuar në drejtim të zgjerimit të gamës së të drejtave për të dhënat personale dhe mirëfunksionimit të mekanizmave të mbrojtjes së këtyre të dhënave.

Natyrisht, mbetemi në dispozicion të anëtarëve të nderuar të këtij komisioni për çdo pyetje ose koment që do të çmohet me vlerë.

Ju faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Pirdeni!

Zonja Dhima, fjala është për ju.

Antonet Dhima – Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit, zonja zëvendësministre për prezantimin e projektligjit!

Ky projektligj vjen si nismë ligjore nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në nenin 121 të Kushtetutës dhe në nenin 17 dhe njëkohësisht edhe në ligjin 43/2016 “Për marrëveshje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në të cilën parashikohet pëlqimi për të qenë i lidhur me një marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruar më parë prej saj, nëpërmjet instrumentit të ratifikimit.

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale. Legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale përgjithësisht është në përputhje me parimet dhe me frymën që sjell protokollin ndryshues, pasi ndryshimet që i janë bërë këtij ligji në vitin 2012 u mbështetën në harmonizimin tërësor të direktivës së Bashkimit Europian nr. 9546, si dhe në eksperiencën të ngjashme ligjore me vendet e Bashkimit Europian.

Synimi i këtij projektligji është garantimi dhe trajtimi më i mirë i mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me sfidat e reja të privatësisë, që rezultojnë nga përdorimi në rritje i mjeteve teknologjike, si dhe qarkullimit gjithnjë e më të madh të të dhënave personale në kushtet e botës digjitale.

Gjithashtu, me anë të fillimit të procedurave për ratifikimin e këtij protokollit, sipas parashikimeve të vetë protokollit, si dhe në bazë të ligjit nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, vendi ynë plotëson një detyrim ndërkombëtar, si një vend anëtar i Këshillit të Europës.

Cilat janë disa nga risitë kryesore që sjell ky protokoll ndryshues, të cilin ne po e diskutojmë dhe do ta miratojmë sot?

Së pari, garantimi i më shumë të drejtave për subjektet e të dhënave personale, me qëllim pasjen e kontrollit më të madh mbi të dhënat personale të tyre në epokën digjitale, si, për shembull: e drejta për të përfituar nga asistencën e një autoriteti mbikëqyrës të mbrojtjes së të dhënave personale, pavarësisht kombësisë ose vendbanimit; nocioni i ri i parimit të transparencës dhe të së drejtës që ka subjekti i të dhënave në lidhje me të, gjatë procesit të përpunimit të të dhënave personale; e drejta për të mos qenë subjekt i një vendimi që sjell pasojë për subjektin e të dhënave, vendim i cili merret bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, pa marrë parasysh mendimin e tij ose të saj.

Së dyti, zgjerimi i gamës së detyrimeve të kontrolluesit/përpunuesit, në raport me subjektin që i përpunohen të dhënat, si, për shembull, zgjerimi i kategorisë së informacioneve që duhet t'i jepen subjektit kur të dhënat e tij përpunohen; detyrimi i kontrolluesit për të njoftuar pa vonesë Autoritetin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në lidhje me shkeljet e përpunimit të të dhënave, që mund të bien ndesh me të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave.

Së treti, zgjerimi i kategorive të të dhënave sensitive, përpunimi i të cilave do të lejohet vetëm kur kategoritë e duhura janë të parashikuara me ligj. Kështu, në raport me legjislacionin

tonë për mbrojtjen e të dhënave personale, janë shtuar kategoritë, për të cilat ndalohet përpunimi i të dhënave si vijon: të dhënat gjenetike; të dhënat personale, që lidhen me veprat penale, procedimet penale dhe dënimet, si dhe masat përkatëse të sigurisë; të dhënat biometrike, që identifikojnë një person në mënyrë unike; të dhënat personale për informacionin, që zbulojnë të dhënat me origjinë racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimet fetare ose të tjera, shëndetin ose jetën seksuale. Përpunimi i këtyre të dhënave do të lejohet vetëm kur të jenë përcaktuar masa të përshtatshme mbrojtëse në ligj, duke plotësuar këto kërkesa të konventës.

Së katërti, me ratifikimin e protokollit ndryshues, Shqipëria i nënshtrohet detyrimit për të lejuar komitetin e konventës të vlerësojë efektivitetin e masave që ka marrë në legjisllacionin e brendshëm për të zbatuar dispozitat e konventës së modernizuar.

Së pesti, ngritja dhe forcimi i bazës ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar, ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse për të dhënat personale, ndërmjet shteteve të huaja.

Së gjashti, përcaktimi i një regjimi të saktë të flukseve të të dhënave ndërkombëtare.

Së shtati, kërkesa më të forta në lidhje me masën e proporcionalitetit dhe parimet e minimizimit të të dhënave, si dhe ligjshmërinë e përpunimit të këtyre të dhënave.

Së teti, është kufizuar e drejta e palëve për të përjashtuar kategori të ndryshme të përpunimit të të dhënave, përveç rastit që parashikon vetë teksti i protokollit ndryshues në nenin 4, sipas së cilit, paragrafi 2, i nenit 3 të Konventës do të zëvendësohet me: “Dispozitat e kësaj konvente nuk do të zbatohen për përpunimin e të dhënave të kryera nga një individ në kuadrin e veprimtarive krejtësisht private apo shtëpiake”.

Sa u takon ndërhyrjeve dhe masave ligjore, që duhen ndërmarrë për implementimin e parashikimeve të protokollit ndryshues, sqarojmë se, referuar nenit 4 të konventës, të ndryshuar me nenin 6 të protokollit ndryshues, secila palë do të marrë masat e nevojshme në ligjin e saj, për të zbatuar dispozitat e kësaj konvente dhe për të siguruar zbatimin efektiv të tyre. Këto masa do të ndërmerren dhe do të hyjnë në fuqi në kohën e aderimit ose të ratifikimit të kësaj konvente dhe do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit të efektivitetit nga ana e komitetit të konventës, që do të kontribuojë në mënyrë aktive në këtë proces vlerësimi.

Dua të theksoj se kjo marrëveshje nuk do të ketë efekte financiare në buxhetin e shtetit.

Në kushtet kur ky projektligj, siç e tha dhe zonja zëvendësministre në fjalën e saj, është konsultuar me të gjitha palët dhe janë dhënë mendime edhe nga ministrinë e linjës, në kushtet kur kjo marrëveshje është në të njëjtën frymë dhe në harmoni me rregulloren e përgjithshme të

mbrojtjes së të dhënave të Bashkimit European, të nderuar kolegë dhe kolege deputete, ju ftoj ta miratojmë atë.

Faleminderit!

Nasip Naço – Zonja Dhima, faleminderit për relatimin që i bëtë kësaj çështjeje!

Para se të fillojmë me pyetjet nga kolegët, kam një pyetje për ju, zonja Pirdeni, dhe për stafin tuaj, në lidhje me nenin 8 të kësaj konvente: “Përcaktohen dhe të dhënat personale në lidhje me veprat penale, procedimet penale dhe dënimet, si dhe masat përkatëse të sigurisë”. Pra, përveç të dhënave gjenetike, do të thotë që do të lejohen vetëm kur të jenë përcaktuar masa të përshtatshme mbrojtëse me ligj, duke i plotësuar sipas këtij legjislacioni dhe kësaj konvente.

Pyetja ime është: a përpunohen aktualisht këto të dhëna? Pra, të dhënat që kanë të bëjnë me të dhënat personale në lidhje me veprat penale, procedimet penale, dënimet, si dhe masat përkatëse të sigurisë.

Di që në Ministrinë e Drejtësisë është një inventar statistikor, ku përpunohen gjatë gjithë kohës të dhëna, përpunohen në prokurori, jepen informacione për institucione të ndryshme, për partnerët ndërkombëtarë. Këtu thuhet që këto të dhëna do të jepen në momentin kur do të përcaktohen saktë në ligj.

Nëse mund të na sqaroni pak më shumë në lidhje me këtë pyetje...

Faleminderit!

Adea Pirdeni – Faleminderit për pyetjen, i nderuar kryetar!

Për sa u përket të dhënave personale, sikurse e përmendët dhe ju, le të themi, informacioni mbi të dhënat në lidhje me veprat penale, procedimet penale, si dhe dënimet janë informacione ku duhet të segregohet se çfarë është e dhënë personale dhe çfarë janë të dhënat të cilat mund të përdoren për qëllime statistikore. Sikurse edhe ju iu referuat, në inventarin statistikor të Ministrisë së Drejtësisë botohen kryesisht të dhëna të natyrës sasiore, pra jo të dhëna që referojnë konkretisht të dhënat personale të një individi ose të individëve të caktuar, që kanë qenë subjekte të veprës penale.

Neni 8 i konventës parashikon për herë të parë një gamë të shtuar të atyre të dhënave që quhen të dhëna me natyrë sensitive.

Në ligjin aktual “Për mbrojtjen e të dhënave personale” është parashikuar shprehimisht se cilat janë të dhënat që konsiderohen sensitive dhe, në fakt, publikimi i këtyre të dhënave sigurisht që i nënshtrohet një regjimi tjetër. Këtu dua t’i referohem jo vetëm ligjit “Për mbrojtjen e të

dhënave personale”, por edhe vendimit nr.16 të vitit 2004 të Gjykatës Kushtetuese, që sanksionon shprehimisht se të dhënat sensitive, si ato të listuara në nenin 8, i nënshtrohen një regjimi të ndryshëm, siç e parashikon edhe konventa. Masat mbrojtëse për këto kategori të drejtash janë të shtuara në sensin që, marrja e këtij informacioni dhe vënia e tij në dispozicion të çdo subjekti të tretë, duhet të kryhet në bazë të rregullave të parashikuara shprehimisht nga ligji, e para, duke marrë pëlqimin e subjektit, ose në raste të tjera të veçanta, duke zbatuar të gjitha garancitë që parashikon Kushtetuta dhe ligji në funksion të dhënies së këtyre të dhënave ose vënies në dispozicion të palëve të treta.

Nasip Naço – Një pyetje tjetër: nëse një qytetar apo një gazetar do të kërkonte të merrte dëshminë e penaltetit të një personi të dënuar, mbrohet në këtë rast, apo çdo gazetar mund të kërkojë, në bazë të të drejtës për informim, dhe të marrë informacion për çdo të dënuar që është në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve?

Adea Pirdeni – Sipas ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, këto konsiderohen të dhëna sensitive. Pra, të dhëna që kanë të bëjnë me dënimin e personit futen në kategorinë e të dhënave sensitive.

Nasip Naço – Faleminderit!

Zoti Noka dhe më pas zonja Metaliaj.

Flamur Noka – Unë kam një merak, zoti kryetar.

Zonja zëvendësministre, a e keni konsultuar me patronazhistët projektvendimin që keni sjellë në komision? A keni raportuar në selinë e partisë apo jeni konsultuar me patronazhistët për këtë projektligj, sepse duhet t’ua vini atyre në dispozicion, nuk mund ta kaloni pa u konsultuar me ta, pasi zgjedhjet do të vijnë shpejt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kanë bërë ata vetë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Na sqaro, që nëse e kanë bërë ata vetë, do t’ju lehtësojmë punën edhe juve.

Nasip Naço – Zonja Pirdeni, nëse e vlerësoni se mund të përgjigjeni, vazhdoni.

Adea Pirdeni – Unë do të sqaroj të gjithë procedurën që kemi ndjekur për të kaluar këtë projektakt.

Projektakti është parashikuar shprehimisht në planin analitik të projektakteve të Ministrisë së Drejtësisë. Përveç kësaj, në raportin e Komisionit European për Shqipërinë, për disa vite rresht

është kërkuar shprehimisht nga autoritetet shqiptare marrja e të gjitha masave për ratifikimin e këtij protokollit ndryshues dhe në rastin konkret Shqipëria po plotëson një detyrim ndërkombëtar shumë të rëndësishëm. I gjithë akti dhe procesi i iniciuar nga Ministria e Drejtësisë është bërë në konsultim të plotë me të gjitha institucionet përgjegjëse dhe veçanërisht me institucionin kryesor përgjegjës, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që do të jetë edhe autoriteti mbikëqyrës për zbatimin e kësaj konvente. Ky akt ka kaluar për miratim në Këshillin e Ministrave dhe ka kaluar të gjitha procedurat që parashikon shprehimisht legjislacioni për t'u ratifikuar deri në prezantimin e tij në këtë komision sot.

Flamur Noka – U qartësova, sepse kreu i qeverisë është kreu i patronazhistëve, kështu që patronazhistët qenkan të apdetuar me këtë histori.

Nasip Naço – Zonja Metaliaj.

Lindita Metaliaj – Faleminderit, kryetar!

Kjo konventë është e rëndësishme dhe ratifikimi i protokollit ndryshues ka një rëndësi të veçantë, por unë do të ndalesha kryesisht në dy nenet e saj, te neni 10 i protokollit dhe te neni 15.

Sipas nenit 10 çdo palë duhet të parashikojë në ligj që kontrolluesi të informojë subjektet e të dhënave, e kështu me radhë, pra janë disa arsye pse duhet të informojë paraprakisht subjektet, si dhe çdo informacion shtesë të nevojshëm për të garantuar përpunim të drejtë dhe transparent të të dhënave personale.

Pyetja ime është: zonja zëvendësministre, a ju rezulton që Partia Socialiste, në të cilën ju bëni pjesë, ta ketë zbatuar këtë detyrim për 910 mijë qytetarë të Tiranës, të cilëve iu mblodhën, iu përpunuar dhe iu publikuan në mënyrë të padrejtë, në mënyrë të paligjshme, të dhënat personale? Pra, a kishte një informim paraprak të këtyre qytetarëve për mbledhjen e këtyre të dhënave? Nëse jo, çfarë masash kanë marrë autoritetet për këtë shkelje, të këtij detyrimi të këtij neni përkatës?

Neni 15 parashikon dhe përcakton që çdo palë merr përsipër të vendosë sanksione dhe mjete të përshtatshme gjyqësore dhe jo gjyqësore për shkeljen e dispozitave të kësaj konvente.

E dyta, cilat janë masat dhe sanksionet administrative apo gjyqësore që u morën në rastin e shkeljes dhe publikimit të të dhënave personale pikërisht për 910 mijë qytetarët e Tiranës dhe cilat masa u ndërmorën për publikimin e pagave të 637 mijë qytetarëve për muajt janar-prill 2021, pikërisht për fushatën parazgjedhore, dhe cilat janë masat e ndërmarra për publikimin e targave të 530 mijë qytetarëve, sepse ne e dimë shumë mirë që secili nga ne ka besueshmëri tek institucionet që administrojnë të dhënat personale, administrojnë të dhënat për pagën, administrojnë targat e

automjeteve që ka në pronësi secili nga ne, dhe në momentin që dalin të dhënat personale në mënyrë të paligjshme, pa informuar, dhe mbi të gjitha, kur ndodh, askush nuk vendoset përpara drejtësisë, por përkundrazi, është i pari Kryeministri që krenohet dhe u jep merita të veçanta të gjithë patronazhistëve, që nuk ishin asgjë tjetër, veçse ngritja e një sistemi kriminal pikërisht për t'i nxjerrë dhe për të publikuar të dhënat personale pasi u interesonte për periudhën e zgjedhjeve dhe pikërisht për zgjedhjet e 25 prillit.

Këtë nuk e them unë, zonjë, dhe të nderuar kolegë, por e ka thënë qartë raporti i OSBE-ODIHR-it, raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, raporti i *Transparence International*, të cilët pasqyruan qartë që rrjedhja ishte abuzive, e kundërligjshme dhe ishte pikërisht për të intimiduar dhe frikësuar votuesit në prag zgjedhjesh.

Faleminderit!

Nasip Naço – Zonja Pirdeni.

Adea Pirdeni – Faleminderit për pyetjen!

Në pyetjen tuaj ju iu referuat konkretisht neneve 8 dhe 10 të konventës, të cilat parashikojnë që çdo palë në konventë duhet të parashikojë në ligjet e veta që kontrolluesit duhet të informojnë subjektet dhe sanksionet përkatëse.

Dëshiroj t'ju informoj që kjo konventë, për sa kohë ka ardhur protokollin ndryshues i saj, nuk është ratifikuar dhe nuk është ende në fuqi në Shqipëri.

Gjithashtu, kjo konventë nuk ka hyrë ende në fuqi në shtete të tjera të Këshillit të Europës, sepse deri tani është ratifikuar nga 17 shtete; është nënshkruar nga 27 të tjerë, ndër të cilat janë edhe disa vende të rajonit, përfshirë Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë dhe do të hyjë në fuqi vetëm nëse plotësohen dy kritere: nëse e kanë ratifikuar të gjitha shtetet që e kanë ratifikuar konventën mëmë nr. 108, ku janë 55 shtete, ose deri në datën 11 tetor 2023 këtë konventë ta kenë ratifikuar së paku 38 shtete. Kjo konventë nuk është ende në fuqi në nivel evropian, por natyrisht që ne marrim të gjitha masat për të qenë në të njëjtën linjë me legjislacionin e vendeve të tjera dhe legjislacionin ndërkombëtar në këtë fushë.

Për sa u përket masave konkrete për cenimin e të dhënave personale, ligji aktual parashikon shprehimisht, konkretisht neni 39 i ligjit, të gjitha rastet kur ndaj kontrolluesve ose ndaj përpunuesve të të dhënave merren masa të caktuara në formën e sanksioneve administrative kur ka shkelje konkrete të cenimit, të mbrojtjes së të dhënave personale, sikurse parashikon edhe legjislacioni penal, masat konkrete për çdo shkelës dënimi. Institucionet përgjegjëse, respektivisht

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe autoritetet e prokurorisë, sigurisht, janë përgjegjëse për trajtimin rast pas rasti.

Nasip Naço – Faleminderit!

Zoti Baçi, keni fjalën për pyetje.

Flamur Noka – Kam edhe një pyetje tjetër. Ku është serveri i të dhënave?

Nasip Naço – Të lutem, zoti Noka, fjalën e ka zoti Baçi dhe më pas ju.

Flamur Noka – Vetëm një pyetje jam duke i bërë. A kanë ardhur përfaqësuesit e qeverisë për të na dhënë shpjegime?

Nasip Naço – Nuk të ndalon njeri të bësh pyetje. 360 gradë bëji pyetjet, edhe për patronazhistët dhe për të gjithë mund t'i bësh pyetjet.

Flamur Noka – Unë vetëm dua të di se ku është serveri, zotëri? A ka një server ku ruhen të dhënat?

(Diskutime pa mikrofon.)

Nasip Naço – Po, mirë, adresojeni pyetjen, formulojeni si duhet.

Flamur Noka – A më lejohet kjo pyetje, apo jo?

Nasip Naço – Po, tri pyetje lejohen.

Flamur Noka – Shumë bukur.

Ju lutem, a mund ta informoni komisionin se ku ndodhet ky serveri që ruhen të dhënat personale, se mund të jetë një server në parti, një në qeveri, pra na e sqaro që ta dimë?

Nasip Naço – Çështje eksperience është, ndaj, në qoftë se e keni ju, na e thoni, nëse nuk e keni...

(Diskutime pa mikrofon.)

Adea Pirdeni – Normalisht, në bazë të legjislacionit aktual, autoriteti i mbikëqyrës, që garanton zbatimin e këtij ligji, është Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit dhe, normalisht, kjo pyetje duhet t'i drejtohet këtij autoriteti. Ministria e Drejtësisë në rastin konkret është institucion propozues i një projektakti, që paraqitet sot për shqyrtim, i cili synon vendos standarde të reja në këtë fushë.

Nasip Naço – Faleminderit!

Zoti Baçi.

Luan Baçi – Lidhur me sigurinë e të dhënave personale, ligjet prodhohen me bollëk gjithmonë. Ne jemi vendi që kemi ligje shumë të mira, por zbatimi i tyre është për të ardhur keq.

Për platformën e-Albania, shpeshherë kemi pasur ekspozim të të dhënave personale të shumë qytetarëve, ndaj çfarë masash mund të merren që këto të dhëna të mos ekspozohen, plus, duke shtuar edhe tjetrën, që gjithmonë kemi mungesë aksesit në këtë portal?

Adea Pirdeni – Faleminderit për pyetjen!

Në fakt, ky projektakt parashikon pikërisht shtimin e një sërë të drejtash që i takojnë subjektit. Pra, aktualisht nëpërmjet këtij projektakti synohet që të shtohet gama e të drejtave që ka vetë subjekti i të drejtave personale, në krahasim me çfarë ka pasur më përpara. Gjithashtu, nga ana tjetër, janë shtuar edhe detyrimet që kanë të gjitha subjektet që mbajnë, kontrollojnë dhe përdorin të dhënat personale të subjekteve të treta. Kjo do të thotë që ajo çfarë synon pikërisht ky projektakt është jo vetëm t'i japë më shumë të drejta subjektit, por, gjithashtu, të vendosë më shumë të detyrime ndaj të gjitha subjekteve që kontrollojnë të dhënat, duke përfshirë këtu edhe çdo platformë digjitale, si dhe çdo subjekt tjetër kontrollues apo përpunues të të dhënave.

Nasip Naço – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime?

Flamur Noka – Vetëm për patronazhistët ka diskutim.

Nasip Naço – Zoti Noka, e thamë këtë gjë dhe prandaj ju votuat dhe ju falënderoj! 96 deputetë e kanë kaluar ligjin për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe zbatimin e kontratës me “*Jones Group International*”. Besoj se duhet t’ju falënderoj, pasi është një hap për ta përmirësuar më tej këtë drejtim! Duke ju falënderuar edhe për pjesëmarrjen, edhe për votimin, sepse besoj se edhe ju do ta votoni këtë marrëveshje, do të doja që ...

(Ndërhyje pa mikrofon.)

Një pjesë thashë, pasi maxhoranca ka 74 deputetët, ndërkohë që këtë projektligj e kanë votuar 96 deputetë dhe thashë që do t’i falënderoj që morën pjesë.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale””. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Flamur Noka – Kundër jemi ne.

Nasip Naço – Kundër?

Flamur Noka – Po, sigurisht.

Nasip Naço – A do të bëni shpjegim vote?

Flamur Noka – Po, do ta shpjegoj.

Nasip Naço – Po, zoti Noka, mund të shpjegoni votën.

Flamur Noka – Të flasësh për të dhëna personale në një shtet, ku futet derri dhe dosa dhe nuk ka portë që ndalon dhe kontrollon, të flasësh për të dhëna personale në një shtet, ku të dhënat më diskrete të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë nxirren sheshit nëpër zyrat e partisë dhe nëpërmjet të ashtuquajturve patronazhistë apo spiunë të kohëve moderne, është si të flasësh për borën në shkretëtirë. Kështu që në qeverinë tuaj termi “të dhëna personale” nuk ka asnjë kuptim, është e kotë të mendosh dhe të supozosh se po voton një ligj në qeverinë e Edi Ramës dhe ky ligj do të zbatohet. Këtu ka ligj, por sa del nga ky vend, këtu ka një “Maliq”, që është “Maliq” i partisë, kështu që nuk ka nevojë të bëjmë komente më të gjata. Ne jemi kundër, sepse, siç e tha edhe zonja Metaliaj, këtu kanë dalë të dhënat konfidenciale të 910 mijë qytetarëve shqiptarë për efekt politik të fushatës dhe nuk është marrë asnjë ndëshkim, asnjë masë, por vetëm falënderime nga kreu i qeverisë. Që në këtë moment çështja e të dhënave personale në këtë shtet është çështje e vdekur. Këtu asgjë nuk është personale dhe diskrete nëse i intereson kreut të partisë dhe qeverisë.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Noka!

Nuk e kuptova, a ishte votimi juaj individual kundër, edhe shpjegimi, apo është i të gjithë grupit?

Flamur Noka – Dorën e ngritën të gjithë.

Nasip Naço – Jo, vetëm ju, prandaj.

Megjithatë, faleminderit!

Vazhdojmë me miratimin nen për nen të projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale””.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

A do ta shpjegoni votën tuaj kundër për nenin 2, zoti Noka?

Flamur Noka – Jam kundër për të gjitha.

Nasip Naço – Faleminderit!

Miratohet edhe neni 2.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit të ftuarve!

Faleminderit kolegëve të maxhorancës dhe të opozitës!

MBYLLET MBLEDHJA